

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*

20.02.2024
Ora 11:42

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kristian Luigj Shkreli, kryetar bashkie në Bashkinë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: PD (z. M. Logu), PDIU (z. Sh. Sulo)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme kemi dy çështje të cilat kanë mbetur pa u shqyrtuar dhe pa vendimmarrjen përkatëse nga seanca e kaluar. Çështja e parë ka të bëjë me shpërndarjen e fondeve që përfitojnë partitë politike si ndihmë për vitin 2024 dhe çështja tjetër ka të bëjë me vlerësimin e rezultateve të verifikimit të thelluar bërë nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme për kryetarin e Bashkisë Vau-Dejës, zotin Kristian Luigj Shkreli.

Atëherë, fillojmë me projektvendimin që ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për zotin Kristian Shkreli.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*

funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe për kryetarë të bashkisë. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Kristian Luigj Shkreli, kryetar në Bashkinë Vau-Dejës, më datë 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 10052. KQZ bëri verifikimin paraprak dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit konstatohet se zoti Kristian Shkreli, ka deklaruar ndryshimin e të dhënave personale nga mbiemri “Shkreli” e ka kthyer në “Kola”, dhe më pas nga “Kola” e ka kthyer përsëri në “Shkreli”. Në rubrikën “Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit”, ka deklaruar se është marrë masa e dëbimit nga shteti italian dhe ka deklaruar se ka jetuar më shumë se një muaj jashtë Republikës së Shqipërisë, në Torino të Italisë për arsye emigracioni në vitin 2005-2007. Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila në datën 01.02.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Kristian Shkreli. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se: subjekti vetë deklarues, zoti Kristian Luigj Shkreli, Kryetar i Bashkisë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë, për këto arsye i propozojmë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të shprehet me vendim për vazhdimin e mandatit të kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD: Faleminderit zoti Komisioner. Në fakt ne morëm dijeni në lidhje me zhvillimin e kësaj séance, nuk kemi disa dokumente që vlerësojmë që janë shumë të nevojshme në funksion të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ por edhe me qëllim për të mbajtur një qëndrim që është sa më i bazuar në ligj dhe prova. Para se të shprehemi do të kërkonim që paraprakisht të na vireshin në dispozicion praktika e përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, projektvendimi që është përgatitur nga administrata e KQZ-së, formularët e vetëdekriminalizimit për zgjedhjet e viteve 2019, 2021 dhe 2023 të zotit Kristian Shkreli si dhe do të kërkonim që KQZ-ja të marrë një informacion nga SPAK-u lidhur me një kallëzim penal, i cili është aktualisht duke u shqyrtuar nga kjo strukturë e posaçme, pikërisht për një vepër penale që i atribuohet zotit Kristian Shkreli. Pra, do të kërkonim që fillimisht të merreshin këto informacione, që të na vireshin në dispozicion këto praktika shkresore në mënyrë që eventualisht të mund të mbajmë një qëndrim sa më të plotë për rastin konkret dhe projektvendimin që i propozohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për të sjellë në vemendje, ndjesë zoti Komisioner, Për të sjellë në vemendjen tuaj, është e vërtetë që praktika i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme edhe nga KQZ-ja, por ka pasur edhe një kërkesë sipas ligjit për dekriminalizimin nga 16 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë për kryerjen e një verifikimi, po themi të thelluar. Deputetët në fjalë nuk kanë ndonjë përgjigje sepse, besoj se është menduar që kjo çështje do të adresohet nëpërmjet KQZ-së, pra institucionit tuaj. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*

Z. I. Celibashi: Ju faleminderit, sikurse edhe ju e cituat ky proces ka nisur me iniciativë të KQZ-së dhe është konstatuar që edhe 16 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë kanë paraqitur të njëjtën kërkesë për rastin. Dakord me kërkesat që kanë të bëjnë me administrimin e formularëve të vetëdeklarimit për këtë subjekt. Nuk e di se sa lidhje ka kërkesa për të marrë informacion në lidhje për procedimin penal të mundshëm ndaj këtij subjekti nga organet e procedurës qoftë SPAK, apo prokuroria e zakonshme dhe se sa të lidhura janë me çështjen, sepse nuk mendoj që ka ndonjë lidhje për këtë natyrë shqyrtimi dhe për rrethanat e shqyrtimit të kësaj çështje. Por gjithsesi edhe ju mund të bëni një kërkesë kujtdo institucioni tjetër publik për të marrë një informacion për këtë çështje. Gjithsesi ne po e konsiderojmë pozitivisht kërkesën tuaj për ta shtyrë dhe për ta administruar dokumentacionin shtesë të kërkuar nga ana juaj në lidhje me këtë çështje.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD: Faleminderit zoti Komisioner. Në fakt informacioni që ne kërkojmë nga SPAK-u, nuk është një informacion që ka një natyrë të përgjishme apo është një natyrë për çështjen jashtë, po themi jashtë këtij procesi. Ka një çështje po themi që lidhet pikërisht me saktësinë, vërtetësinë e të dhënave, apo mënyrën si janë plotësuar formularët e vetëdekriminalizimit dhe kështu vlerësojmë që ka lidhje me këtë proces. Nëse do të kishim një hetim që ka të bëjë me ushtrimin e detyrave të tij si kryetar bashkie apo nisma tjetër që është jashtë këtij objekti, sigurisht që me të drejtë do të qëndronte ajo që ju sapo thatë. Nëse kemi të bëjmë me një hetim që po kryhet lidhur me mënyrën se si janë plotësuar me saktësi, vërtetësinë e të dhënave, deklaram apo mosdeklaram, vlerësojmë se në këtë rast ka kuptim që të administrohet ky informacion nga ana e strukturës së posaçme. Sigurisht është e drejtë ajo që po thoni që edhe ne mund ta kërkojmë, por besoj kur shkon për çështje

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*

afati dhe pragmatizmi ndoshta edhe për praktikitet besoj, kur një kërkesë shkon nga KQZ-ja, shpejtësia e hapjes së informacionit është më e shpejtë për KQZ-në se sa mund të jetë për palë siç është rasti im. Pastaj do të prisnim të na vinte kjo përgjigje, deri sa të shprehem me një qëndrim lidhur me këtë proces. Do të kërkoja duke vlerësuar qëndrimin tuaj për t'i konsideruar pozitivisht kërkesat tona të para, do të kërkoja që edhe kjo kërkesë në funksion pikërisht të asaj që thashë, të hetimit tonë të gjithanshëm administrativ të kësaj çështje, të merrej parasysh nga KQZ-ja.

Z. I. Celibashi: Dakord, por isha duke thënë që raporti i prokurorisë, rezultatet e hetimit të prokurorisë e kanë evidentuar të gjithë panoramën në lidhje me këtë çështje. Përtej kësaj, dakord nuk kemi asnjë lloj problemi dhe pastaj e vlerësojmë dobishmërinë e këtij informacioni.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: PD (z. Marash Logu), PDIU (z. Sh. Sulo)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirë. Atëherë kalojmë te pika tjetër që ka të bëjë me shpërndarjen e fondeve për partitë politike si ndihmë financiare për vitin 2024. Kemi ndonjë diskutim për këtë?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Në relacionin vënë në dispozicion, ne vëmë re që në pikën 2, të përmbledhjes shpjeguese të përmbajtjes së projektvendimit, e konkretisht, pika “a”, e paragrafit poshtë rezulton nga administrata e KQZ-së që Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet, në zgjedhjet e fundit parlamentare të datës 25 prill 2021, ka fituar 2 mandate. Faktikisht, realisht ne kemi bërë kundërshtimet tona të adresuara në adresë të KQZ-së, ku kemi sqaruar me fakte që PDIU ka 3 mandate. Bashkëngjitur këtij shpjegimi kemi dhe shkresën e Kuvendit të Shqipërisë me nr. Prot 3173/1 datë 23.10.2023, ku midis të tjerash thuhet që PDIU është aktualisht me numër deputetësh tre. Do t’ju kërkonim, i nderuar Komisioner, që të bëhej ndryshimi

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*


nga ana e administratës dhe kjo llogaritur të bëhej për tre deputetë dhe jo për dy deputetë siç është përcaktuar në projektvendim. Kjo të reflektohet në vendimin që do të marrë KQZ. Ne faktikisht e kemi lexuar dhe nenin në të cilin shpjegohet se kush janë partitë apo mënyra sesi fitohet, por nuk kemi ndonjë gjë të përcaktuar që një deputet i kësaj force është bashkuar gjashtë muaj më vonë nga momentin e dhënies së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga ana juaj. Po kështu sjell në vëmendje të këtij komisioni, që vetë ky komision, ka marrë një vendim ku ka përcaktuar që një deputet, konkretisht Gëzim Ademi, është deputet i forcës Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet. Prandaj do të kërkonin që të reflektohej nga ana juaj. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit zoti Sula. Atëhere, në lidhje me kërkesën tuaj, ne kemi këtë shpjegim dhe arsyetim. Është e qartë që në nenin 19 të ligjit “Për Partitë Politike”, përcaktohen rregullat mbi shpërndarjen e fondeve vjetore për partitë politike. Kjo dispozitë e këtij ligji ka përcaktuar që:

- 70 përqind e këtij fondi ndahet bazuar në numrin e deputetëve që një parti politike ka fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare;
- 20 përqind ndahen në mënyrë të barabartë nëpërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë fituar mbi 10.000 vota në zgjedhjet e fundit parlamentare;
- 10 përqind ndahen sipas përqindjes së fituar, partive politike që kanë marr pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar me 1 përqind të votave në shkallë vendi.

Për dy kriteret e listuara të fundit në rradhë, për 20 përqindshin se si ndahet e këtij fondi, 10 përqindshi i këtij fondi se si ndahet besoj se nuk kemi asnjë lloj diskutimi dhe paqartësie. Është e qartë për të gjithë. Diskutimi është mbi kriterin mbi të cilin ndahet 70 përqind e këtij buxheti. Ligji thotë që “ndahet sipas numrit të deputetëve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*

të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare”. Këtë numër e përcakton rezultati përfundimtar i zgjedhjeve i shpallur nga KQZ. Sipas rezultatit përfundimtar që ka shpallur KQZ-ja për zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prillit 2021, kemi këtë numër deputetësh:

- Partia Socialiste ka 74 deputetë;
- Partia Demokratike 50 deputetë;
- Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet ka 2 deputetë;
- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut ka 1 deputet;
- Partia Republikane ka 3 deputetë;
- Partia Agrare Ambientaliste ka 1 deputet;
- Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka 1 deputet;
- Partia Lëvizja e Legalitetit ka 1 deputet;
- Partia e Lirisë ka 4 deputetë, dhe
- Partia Socialdemokrate ka 3 deputetë.

Natyrisht që në këtë moment numri i deputetëve që ka Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet nuk është 2, por është 3. Ne nuk e kontestojmë, nuk kemi asnjë arsye për ta kontestuar përgjigjen që ka sjellë Kuvendi i Shqipërisë në lidhje me numrin e deputetëve që ka kjo forcë politike. Por ligji “Për Partitë Politike” merr si moment të llogaritjes dhe të konsiderimit të numrit të deputetëve që ka një parti politike, mbi të cilën bëhet llogaritja për fondin që merr kjo parti politike, lidhet me sa numër deputetësh ka marrë bazuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Gjatë legjislaturës për rastin e Koalicionit të “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” deputetët mund të ikin dhe të lenë mandatin. Ai që vjen në rradhë mund të jetë i partisë që i përkiste deputeti që ka lënë mandatin ose jo?! Pra, mund të ndryshojë përkatësia, ndaj dhe ligji ka përcaktuar që llogaria bëhet mbi numrin e mandateve që një parti politike ka fituar bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të shpallura me vendim

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*

të KQZ-së. Kështu që bazuar në këtë kriter, ne kemi bërë dhe përlllogaritjen për të gjitha forcat politike që kanë të drejtë të përfitojnë mandatin. Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër?! Nuk kemi!

Faleminderit! Atëherë, përfundimisht bazuar në çfarë arsyetuar dhe dispozitat përkatëse të ligjit “Për Partitë Politike” shuma që partitë politike përfitojnë si ndihmë financiare për vitin 2024 nga buxheti shtetit është si vijon:

Partia Socialiste e Shqipërisë përfiton 151.494.783 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

- Partia Demokratike përfiton 106.661.181 (njëqind e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë.

- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet përfiton 9.753.658 (nëntë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.

- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut përfiton 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë.

- Partia Republikane Shqiptare përfiton 11.488.669 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

- Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë përfiton 8.018.647 (tetë milionë e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë.

- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar përfiton 8.018.647 (tetë milionë e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë.

- Partia Lëvizja e Legalitetit përfiton 8.018.647 (tetë milionë e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë.

- Partia e Lirisë përfiton 15.577.215 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

- Partia Socialdemokrate përfiton 12.266.269 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.02.2024*

- Partia Nisma Thurje përfiton 6.283.636 (gjashtë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

Këto janë shumat që përfitojnë partitë politike. Secila prej tyre do ta marrë këtë shumë, ose do të bëhet e disponueshme për secilën prej tyre me kushtin që të kenë depozituar në KQZ brenda datës 31 mars, raportin financiar për shpenzimet financiare dhe të ardhurat për vitin që shkoi. Pra, për vitin 2023, përndryshe këto fonde nuk do t'i shpërndahen.

Mirë faleminderit! Çështje të tjera kemi? Nuk kemi? Seanca mbyllet! Ditë të mbarë!

Vendimi nr. 20

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

